

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Trump ndërpret qëndrimin në Camp David dhe kthehet në Shtëpinë e Bardhë mes tensioneve në Lindjen e Mesme - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/trump-nderpret-qendrimin-ne-camp-david-dhe-kthehet-ne-shtepine-e-bardhe-mes-tensioneve-ne-lindjen-e-mesme/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 07:13:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 06:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b41cc346d40e7118984db30d8cafdb47f6afc5b323a81e83fdcdba4ec12ffb1
TEKSTI	7c7dfe0a53101c86d6b4e8cd0b85a614bcb13d3f10dcfb27925b50befd6c44c
PAMJA	b8a9ceb39af744f427d8f287bda0addfc47207bb7f6a661e44b8739c4ec1d999

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ae4f61b43a8f899ca8f98e2193b70a24c4fc94c8e5a4b75eb08008be0cfbafc7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	a94744ba6f340a0d35e86c725f9a3ff2353c45c48cf148fa90ea824c18d037c8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ae4f61b43a8f899ca8f98e2193b70a24c4fc94c8e5a4b75eb08008be0cfbafc7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Trump ndërpret qëndrimin në Camp David dhe kthehet në Shtëpinë e Bardhë mes tensioneve në Lindjen e Mesme

BOTË

Demo

Trump ndërpret qëndrimin në Camp David dhe kthehet në Shtëpinë e Bardhë mes tensioneve në Lindjen e Mesme

SEPTEMBER 20, 2026



Presidenti amerikan Donald Trump ka ndërprerë qëndrimin e planifikuar në rezidencën presidenciale Camp David dhe është kthyer në Shtëpinë e Bardhë, një ditë më herët se sa ishte parashikuar, në një kohë kur tensionet në Lindjen e Mesme janë përshkallëzuar.

Trump kishte planifikuar të qëndronte gjatë gjithë fundjavës në Camp David, ndërsa sipas agjendës së publikuar më herët, kthimi i tij në Uashington ishte parashikuar për të dielën. Administrata amerikane nuk ka dhënë një arsye zyrtare për ndryshimin e papritur të axhendës së presidentit.

Megjithatë, kthimi i parakohshëm i Trumpit në Uashington vjen në një moment të ndjeshëm për situatën në Lindjen e Mesme, pas një sulmi të pretenduar nga rebelët Houthi ndaj kryeqytetit saudit, Riadit.

Të shtunën, Houthit deklaruan se kishin sulmuar me raketa dhe dronë disa objektiva në Riad. Forcat e koalicionit të udhëhequr nga Arabia Saudite thanë se kishin interceptuar një raketë balistike të drejtuar drejt kryeqytetit, ndërsa autoritetet saudite aktivizuan alarmet e mbrojtjes ajrore. Më pas u dha njoftimi për përfundimin e rrezikut.

Ky zhvillim përbën një përshkallëzim të rëndësishëm, pasi sulmet e Houthis ndaj Arabisë Saudite gjatë kësaj vale të konfliktit kishin prekur kryesisht qytete të tjera, infrastrukturën energjetike dhe objektiva përgjatë Detit të Kuq. Sulmi i raportuar ndaj Riadit ishte ndër zhvillimet më të fundit që kanë rritur shqetësimet për zgjerimin e konfliktit në rajon.

Në të njëjtën kohë, Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, është kthyer drejt Uashingtonit pas një vizite në Teksas, ku kishte marrë pjesë në aktivitete të planifikuara më herët. Lëvizja e tij është raportuar në të njëjtën kohë me kthimin e Trumpit në Shtëpinë e Bardhë.

Ndërkohë, Departamenti Amerikan i Shtetit lëshoi të shtunën një alarm sigurie për qytetarët amerikanë në Lindjen e Mesme, duke përmendur sulmet e Houthis dhe rrezikun e përshkallëzimit të mëtejshëm të situatës.

Departamenti i Shtetit u bëri thirrje amerikanëve që ndodhen në rajon të tregohen më vigjilentë, ndërsa qytetarëve amerikanë jashtë Lindjes së Mesme u kërkoi të "rishqyrtojnë seriozisht udhëtimin për në dhe përmes rajonit".

Kthimi i Trumpit në Uashington nuk është shoqëruar deri tani me një njoftim zyrtar që ta lidhë drejtpërdrejt vendimin me zhvillimet ushtarake në Lindjen e Mesme. Megjithatë, koha e lëvizjes së presidentit përkon me rritjen e tensioneve dhe me paralajmërimet e reja amerikane për sigurinë në rajon.

President Trump returns to the White House Saturday evening after departing Camp David as his administration weighs its next steps in the war with Iran. Trump is preparing for a major week in New York, where the Iran conflict is expected to be a focus as world leaders gather for the U.N. General Assembly. Iran says it has

Postimet e reja

Fico: Disa politikanë perëndimorë po kërkojnë...

SEPTEMBER 20, 2026

Trump ndërpret qëndrimin në Camp Davi...

SEPTEMBER 20, 2026

OpenAI zbulon 6 raste shqetësuese të AI-së:...

SEPTEMBER 20, 2026

"Çerçiz Topulli" që shkaktoi polemika,...

SEPTEMBER 20, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Pas shpalljes së listës së fituesve të "Grant 2026" kanë nisur të dalin rastet ku...

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe "problematikët"

Na ndiq

Facebook

Instagram

presented conditions for ending the conflict and is awaiting Trump’s response.
— Fox News (@FoxNews) September 20, 2026



Camp David Trump

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A
Email: radarlajme@gmail.com
Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri: Horoskopi për të gjitha shenjat



Aleanca për Media Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.